



| | |
|--|--------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E VUSHTRISË | |
| KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN | |
| 01 Nr. / Br. | 63/21 |
| Nr. i fq. / Br. st | - 2 - |
| Data: / Datum | 25. 03. 2021 |
| VUSHTRRI - VUČITRN | |



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

| | |
|--------------|--|
| PËR: | z.Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, z.Ymer Haradinaj, anëtar i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, z.Lutfi Gërugri, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, znj.Ragbete Krasniqi, Drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit |
| NGA: | Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Nasuf Aliu |
| TEMA: | REKOMANDIM |

Inderuar kryetar i komunës,

Inderuar anëtar i kuvendit,

Tënderuar drejtor,

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **25 mars 2021**, pas shqyrtimit të peticionit të banorëve të fshatit Stanoc i Epërm të parashtruar në emër të Ymer Haradinajt, anëtar i kuvendit, lidhur me kundërshtimin e marrëveshjes së lidhur mes kryetarit të Komunës së Vushtrrisë z.Xhafer Tahiri dhe z.Xhelal Ismajlit, pronar i fabrikës së tekstilit "VITEX", që ka të bëjë me kundërshtimin e shfrytëzimit të objektit të vjetër të shkollës fillore "Migjeni", për qëllime biznesore, pas debateve dhe analizës së hollësishme të lartë shënuarve iu parashtron këtë:

REKOMANDIM

I Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë rekomandon që fabrika e tekstilit "VITEX" të vazhdojë aktivitetin biznesor në objektin e vjetër të shkollës fillore "Migjeni", konform kontratës të lidhur me Komunën e Vushtrrisë.

II Qeveria Komunale, gjegjësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në planifikimin e buxhetit të komunës për vitin 2022, ti inkorporoj këto projekte: ndërtimin e çerdhes së fëmijëve, këndin për lexim dhe fushën sportive.



ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, pas debateve dhe analizave të hollësishme, e ka shqyrtuar peticionin e banorëve të fshatit Stanoc i Epërm, ku ka vlerësuar se është imediate dhe tepër e nevojshme hapja e vendeve të reja të punës, andaj konsideron se biznesit të lartëcekur duhet ti jepet muhdësia, që të filloj me investimin dhe realizimin e projektit për hapjen e asaj fabrike dhe vendeve të reja të punës. Andaj nga vlerësimet e bëra, kuvendi e hedhë poshtë peticionin e banorëve të fshatit Stanoc i Epërm lidhur me kundërshtimin e marrëveshjes të lidhur mes kryetarit të Komunës së Vushtrrisë z.Xhafer Tahiri dhe z.Xhelal Ismajlit, pronar i fabrikës së tekstitit "VITEX".

Kuvendi merr në konsideratë shqetësimet e banorëve të fshatit Stanoc i Epërm, dhe obligon qeverinë komunale që të realizoj projektet që lidhen me ndërtimin e çerdhes së fëmijëve, këndin për lexim dhe fushën sportive në fshatin Stanoc i Epërm.

Me respekt!